

FINAL

RAPORT I ADMINISTRATORIT DHE PERFAQESUESIT LIGJOR TE SHOQERISE

“FINAL” SH.A.

MBI TRANSFORMIMIN

NGA SHOQERI AKSIONARE NE SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Date: 26.11.2020

Drejtuar: Keshillit te Administrimit te Shoqerise "FINAL" ShA, dhe
Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te “FINAL” ShA.

Ne kete raport ju lutem te gjeni nje raport te hollesishem, ne te cilin pershkruhet:

- baza ligjore dhe ekonomike per shnderrimin e shoqerise “FINAL” ShA., (“Shoqeria”) nga nje Shoqeri Aksionare (“Sh.A.”), ne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.);
- veshtiresite e veçanta te vleresimit mbi transformimin (nese jane hasur);
- efektet qe do te sjelle ky shnderrim i formes ligjore te Shoqerise ndaj punemarresve te saj.

1. Pershkrim:

Shoqeria aksionare “FINAL” Sh.A., eshte regjistruar prane regjistrimit tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB), me date 11.01.2008, mban NUIS - K81311012P, me seli prane Rruga Idriz Dollaku, Pallati i Ri, kati i parafundit, ZK 8180, Tirane, Shqiperi (ne vijim referuar si “Shoqeria”).

Kjo shoqeri ka nje kapital te regjistruar prej 100.000.000 (njqind milion) Leke i ndare ne 1.000.000 (nje milion) aksione te zakonshme, me vlere nominale 100 (njqind) Leke secila.

Shoqeria aksionare “FINAL” Sh.A., eshte e zoteruar nga aksionari i vetem Z. Arben Meskuti, shtetas shqiptar, identifikuar me Nr. H81006117C personal, zoterues i 1.000.000 (nje milion) aksione te zakonshme te kapitalit (100% te kapitalit), me te drejte vote.

FINAL eshte e organizuar si shoqeri aksionare, struktura organizative e te ciles perbehet nga Asambleja e Pergjithshme e Aksionarit, Keshilli i Administrimit dhe Administratori, i cili eshte edhe perfaqesuesi



FINAL

ligjor i Shoqerise.

Objekti i veprimtarise te FINAL konsiston ne Qera Financiare. Kredidhenie. Per qellimin e realizimit te objektit te mesiperm, Shoqeria mund edhe: te kryeje çdo aktivitet te ligjshem qe lidhet me pasuri te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie me qira ose venien e hipotekave, pengjeve, barrave siguruese apo çfaredolloj garancie tjeter, edhe ne favor te te treteve, qe mund te konsiderohet i dobishem ose i nevojshem per realizimin e qellimeve te Shoqerise; te fitoje, ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte, interesa ne shoqeri te tjera te cilat kane nje objekt te ngjashem me ate te Shoqerise, ne Shqiperi ose jashte saj; dhe te kryeje çdo aktivitet tjeter qe mund te konsiderohet i dobishem ose i domosdoshem per realizimin e qellimeve te Shoqerise. Per me teper, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga legjislacioni ne fuqi. Për te gjitha format e kredidhënies.

2. Baza ligjore:

Procesi i shnderrimit te shoqerise aksionare "FINAL" Sh.A. ne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, bazohet ne dispozitat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, (ne vijim "Ligji tregtar"), e perkatesisht te neneve 228, 229, si dhe 221, 222,223 e 224 te ketij ligji.

Keto dispozita, percaktojne se shoqeria aksionare (SH.A.) mund te shnderrohet ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.), dhe anasjelltas, duke respektuar parashikimet e Ligjit Tregtar, dhe ato Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", i ndryshuar.

Ky shnderrim i formes ligjore nga shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

3. Paitimi me liqjin, statutin dhe kontratat:

Transformimi i shoqerise FINAL nga Sh.A. ne Sh.P.K. kryhet ne perputhje me nenet 228-229 te Ligjit Tregtar dhe statutin e shoqerise. Gjate ketij procesi te transformimit te formes se shoqerise, nuk do ta ndryshoje objektin e veprimtarise, dhe forma ligjore e re e saj nuk e pengon shoqerine te permbushe ligjerisht e ne te njejten menyre objektivat dhe synimet e shoqerise, si dhe te realizoje mbrojtjen e interesave te aksionarit.

Transformimi nuk bie ne kundersizim dhe nuk perben shkelje te ndonje kontrate apo marreveshje ne te cilat shoqeria eshte pale.



FINAL

4. Efektet e shnderrimit tek punemarresit dhe palet e treta:

Transformimi i formes ligjore te shoqerise FINAL ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nuk cenon marredheniet, e te drejtat dhe detyrimet e ndermarra nga FINAL kundrejt punemarresve ekzistues te kesaj shoqerie apo ndaj paleve te treta me te cilat kjo shoqeri ka marreveshje bashkepunimi. Ne cilesine e Administratorit dhe Perfaqesuesit Ligjor te shoqerise FINAL deklaroj se transformimi nuk do te dobesoje apo cenoje ne ndonje menyre poziten e aksionarit te shoqerise FINAL.

5. Ndryshimet e detyrueshme - hapat per tu ndiekur lidhur me transformimin e formes ligjore:

Per te realizuar transformimin e formes ligjore te shoqerise FINAL nga nje shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar duhet qe Asambleja e Aksionarit te vetem, bazuar ne raportin dhe propozimin e Administratorit te FINAL, t'i parashtojte Aksionarit te shoqerise nevojen per ndryshimin e formes ligjore te shoqerise nga nje "shoqeri aksionare" ne "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar", ne perputhje me dispozitat ligjore te Ligjit Tregtar. Ky proces kerkon qe aksionari i FINAL te miratojne propozimin per te realizuar kete ndryshim si dhe te miratojne statutin e ri te shoqerise ne formen ligjore Shoqeri me Pergjegjesi e Kufizuar.

6. Arsvet e transformimit:

Transformimi i shoqerise nga shoqeri aksionare ne formen shoqeri me pergjegjesi te kufizuar propozohet te kryhet per mire- administrimin e veprimtarise tregtare te shoqerise FINAL, e cila ne perputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar ne fuqi mund te kryhet nga subjekte tregtare te strukturuara si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

7. Realizimi dhe perfundimi i transformimit:

Ne perputhje me parashikimet e neneve 228-229 te Ligjit Tregtar, ndryshimi i formes ligjore te shoqerise FINAL nga SH.A. ne SH.P.K. do te hyje ne fuqi ne daten e regjistrimit perfundimtar te transformimit prane regjistrin tregtar mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit.

8. Baza dhe pasojat ekonomike per shnderrimin nga SH.A ne SH.P.K:

a) *Ndikimi i transformimit nga SH.A. ne SH. P. K. mbi kapitalin e regjistruar dhe pjesemarrjen:*

Kapitali aktual aksionar i shoqerise FINAL, eshte prej 100.000.000 (njqind milion) Leke i ndare ne 1.000.000 (nje milion) aksione te zakonshme, me vlere nominale 100 (njqind) Leke secila. Kapitali

FINAL

aksionar i FINAL zoterohet nga aksionari i vetem Z. Arben Meskuti, shtetas shqiptar, identifikuar me Nr. H81006117C personal, zoterues i 1.000.000 (nje milion) aksione te zakonshme te kapitalit (100% te kapitalit), me te drejte vote.

Kapitali i shoqerise eshte i perbere teresisht nga kontribute ne para dhe eshte i shlyer nga aksionari i shoqerise "FINAL" SH.A.

Kapitali i shoqerise FINAL SH.P.K do vazhdoje te zoterohet ne te njejten mase nga po i njejti individ, sic percaktohet me lart, edhe ne vijim te transformimit ne SHPK, ne cilesine e ortakut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, zoterues i vetem i 1 (nje) kuote te kapitalit, e cila perfaqeson 100% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise ne vleren aktuale prej 100.000.000 (njeqind milion) Leke. Konkretisht, pas transformimit ortaku i vetem Z. Arben Meskuti, shtetas shqiptar, identifikuar me Nr. H81006117C personal i FINAL SH.P.K., do te zoteroje 100% te kuotes se saj.

b) Ndikimi i transformimit nga SH.A. ne SH. P. K. mbi kerkesat per kapital minimal:

Ne vijim te transformimit te shoqerise FINAL nga SH.A. ne SH.P.K., kjo e fundit nuk do te kete me detyrimin ligjor per ruajtjen e kapitalit minimal ne jo me pak se 3.5 milion Leke ne perputhje me parashikimet e Nenit 107.1 te Ligjit Tregtar, per kapitalin minimal te shoqerive aksionare.

c) Ndikimi i transformimit nga SH.A. ne SH.P.K. mbi rezervat ligjore:

Bazuar ne parashikimet e Nenit 127 te Ligjit Tregtar, shoqerite aksionare kane detyrimin per te krijuar rezerva ligjore ne masen 5% te fitimit pas tatimit se periudhes dhe ne cdo rast vlere totale e rezerves nuk do te kaloje 10% te kapitalit aksionar te regjistruar dhe paguar. Gjate ekzistences se saj, FINAL nuk ka krijuar rezerva ligjore pasi kushtet per krijimin e tyre nuk jane permbushur. Si rrjedhim, shnderrimi i shoqerise FINAL nga SH.A. ne SH.P.K. dhe shuarja e detyrimit ligjor per krijimin dhe ruajtjen e rezerves ligjore nuk ka asnje pasoje ne periudhen aktuale apo ato vijuese.

d) Ndikimi i transformimit nga SH.A. ne SH. P. K. mbi aktivet dhe detyrimet e Shoqerise

Transformimi nuk do te ndikojte dhe as nuk shkakton asnje efekt apo ndryshim te aktiveve dhe pergjegjesive te shoqerise ndaj te treteve te cilat jane te regjistruara rregullisht ne librat e shoqerise ne perputhje me parashikimet e standardeve te aplikueshme te kontabilitetit sipas kerkesave te Ligj 25/2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" ("Ligji per Kontabilitetin").



FINAL

e) *Efektet e transformimit tek punemarresit dhe organet drejtuese te Shoqerise*

Keshilli i Administrimit te FINAL SH.A., shperbehet si organ. Ky ndryshim nuk ka asnje efekt mbi shoqerine pasi kjo e fundit nuk kishte asnje kostot shtese ne lidhje me ushtrimin e funksioneve te tyre nga ana e anetareve te Keshillit te Administrimit.

Transformimi nuk do te ndikojë ne marrëdhëniet e punesimit ndërmjet FINAL dhe punemarresve te saj duke qene se nuk ka efekte mbi kontratat e punes apo mbi aktivitetin tregtar te zakonshem te shoqerise.

f) *Efektet e transformimit mbi raportimin financiar dhe auditimin ligjor te pasqyrave financiare:*

Perpara transformimit, FINAL konsiderohej "njesi ekonomike me interes publik" ne kuptim te Ligjit per Kontabilitetin dhe ne perputhje me parashikimet e Nenit 5.2 te ketij ligji ka zbatuar Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF") per qellime te raportimit financiar. Gjithashtu, pasqyrat financiare te Shoqerise u jane nenshtruar rregullisht auditimit ligjor ne perputhje me parashikimet e shkronjes a) te Nenit 41 te Ligjit nr. 10 091, date 5.3.2009, "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar (ne vijim "Ligji per Auditimin Ligjor").

Me vazhdimin e ushtrimit te veprimtarise tregtare sipas kerkesave te Bankes se Shqiperise ne perputhje me Ligjin per Auditimin Ligjor dhe ne vijim te transformimit nga SH.A. ne SH.P.K., per vitin 2020 e ne vazhdim Shoqeria do t'u nenshtrohet parashikimeve ligjore per qellime te hartimit te pasqyrave financiare vjetore.

Bazuar ne sa me lart, pas transformimit Shoqeria do te vazhdoje te pergatise pasqyrat e saj financiare mbi bazat e SKK dhe keto pasqyra do t'i nenshtrohet auditimit ligjor. Pasqyrat financiare gjithashtu duhet te pergatiten ne perputhje te plote me kerkesat e Kreut III te Ligjit per Kontabilitetin per sa i perket formes dhe permbajtjes.

g) *Efektet e transformimit mbi raportet vjetore per t'u pergatitur:*

Ne vijim te transformimit te FINAL nga SH.A. ne SH.P.K., Shoqeria ne fund te gdo viti financiar duhet te siguroje perputhshmerine me kerkesat e Ligjit per Kontabilitetin per sa u perket raporteve te cilat duhet te shoqerojne pasqyrat financiare vjetore. Detyrimi per pergatitjen e ketyre raporteve do te duhet te percaktohet gjithashtu edhe ne baze te madhesis se shoqerise sipas klasifikimeve te parashikuara ne Ligjin per Kontabilitetin.



FINAL

h) Efektet liqjore te transformimit

Regjistrimi i shnderrimit se shoqerise nga shoqeri aksionare ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do te kete efektet vijuese:

- i. Shoqeria qe shnderrohet te vazhdoje te ekzistoje ne formen ligjore te percaktuar ne vendimin e shnderrimit;
- ii. Aksionari i shoqerise qe shnderrohet vazhdon te marri pjese ne shoqerine e re si ortak, sipas kushteve te percaktuara ne Ligjin Tregtar per formen e re te shoqerise: Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar;
- iii. Te drejtat e personave te trete per aksionet e shoqerise qe transformohet vazhdojne te zbatohen edhe per kuotat e shoqerise se shnderruar ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Per llogari te:

"FINAL" Sh.A.

ADMINISTRATORI

Vasil BAKALLBASHI



**VENDIM I AKSIONARIT TË VETËM
TË SHOQËRISË "FINAL" SHA**

Datë 26/11/2020

Sot, më datë 26.11.2020, Z. Arben Meskuti, banues ne Tirane, i identifikuar me karte identiteti me nr 033812213 dhe nr personal H81006117C, në cilësinë e Aksionarit të Vetëm të shoqërisë "FINAL" SHA ("Shoqëria"), institucion financiar jo-banke, e themeluar dhe që e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: Rruga Idriz Dollaku, Pallati i Ri, kati i parafundit, ZK 8180, Tirane e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit K81311012P, i cili vendosi mbi rendin e ditës për sa më poshtë vijon:

Miratimi per shnderrimin e formes ligjore te Shoqerise "FINAL" Sh.A. nga shoqeri aksionare, ne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nga data e ketij vendimi.

Sipas rendit të ditës;

Miratimi per shnderrimin e formes ligjore te Shoqerise "FINAL" Sh.A. nga shoqeri aksionare, ne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nga data e ketij vendimi.

Aksionari i Vetëm vendosi si vijon:

* * *

VENDIM

"Miratohet shnderrimi i formes ligjore te Shoqerise "FINAL" Sh.A. nga shoqeri aksionare, ne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nga data e ketij vendimi."

Ngarkohet administratori i shoqerise per te kryer veprimet sipas ligjit prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB).

Aksionari i Vetëm



Arben MESKUTI
